



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1275 Prot.

Tiranë, më datë 16.12.2020

VENDIM
Nr. 489, datë 16.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.12.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin kërkesës nga shoqëria A&E Engineering, për kryerjen e sondazheve të themeleve në objektet: Hamami në oborrin e shkollës “16 Shtatori” Durrësit dhe Banesa “Aleksandër Moisiu”
2. Gjatë procesit të sondazhit të themelit duhet të jenë prezent : Personi i licencuar në arkeologji, përfaqësuesit e firmës dhe të Drejtorisë Rajonale. Raporti i sondazhit të themelit duhet të depozitohet pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: c=AL, o=Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, ou=Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, cn=Arta Dollani
Date: 2020.12.16 17:08:00 +0100

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.12.16
18:05:38 +01'00'